



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.11.2022, ora 14:00

Drejton mbledhjen Sokol Binaj – Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

Rendi i Ditës:

1. Diskutim i relacionit të përgatitur nga relatori për kandidaten zj. Mariana Semini, në vendin vakant të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese z. Altin Binaj, të shpallur nga Kuvendi (relatore K. Veizi);

Marrin pjesë:

- | | |
|--------------------------|----------------------|
| 1. Sokol Binaj | (kryetar) |
| 2. Marsida Xhaferllari | (zëvendës kryetare) |
| 3. Elsa Toska | (anëtare) |
| 4. Anila Leka | (anëtare) |
| 5. Edlira Petri | (anëtare) |
| 6. Klodiana Mema (Veizi) | (anëtare) |
| 7. Etien Kapo | (anëtar) |
| 8. Enton Dhimitri | (anëtar) |
| 9. Sandër Simoni | (anëtar zëvendësues) |

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:

- 1. Enio Haxhimihali**, përfaqësues me autorizim i Avokatit të Popullit

HAPET MBLEDHJA: ora 14.20

Kryetar Sokol Binaj – Atëherë çelim mbledhjen e caktuar për datën e sotme, me rend dite “*Diskutim i relacionit të përgatitur nga relatori për kandidaten zj. Mariana Semini, në vendin vakant të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese z. Altin Binaj, të shpallur nga Kuvendi më datë 16.01.2022*”.

Verifikojmë prezencën e pjesëmarrësve. Paraprakisht ju informoj se mbledhja filloj 20 min me vonëse për shkak të impenjimit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese pjesë të KED-së në gjykimet pranë kësaj gjykate.

Janë të pranishëm, zonja Toska, zonja Leka, zonja Petri, zoti Dhimitri, zoti Kapo, zonja Mema dhe Binaj. Ndërkohë edhe gjyqtare Marsida Xhaferllari është duke ardhur. Mbledhja zhvillohet në prezencë të përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, zoti Haxhimihali.

Eshtë i pranishëm në pozicionin e zëvendësuesit zoti Simoni.

Atëherë vazhdojmë.

Fjalën e ka zonja Mema për paraqitjen e raportit.

Klodiana Veizi (Mema) – unë e kam paraqitur. Është lexuar relacioni. Janë njohur anëtarët. Është kërkuar kohë për tu njohur me aktin e ILDKPIK-së, raportin e pasurive, duke qënë se nuk ishte përcjell nëpërmjet emailit. Kështu që kemi mbetur tek diskutimi. U kërkua nga zonja Petri kohë dhe nga anëtarë të tjerë.

Sokol Binaj- dakort atëherë, jeni njohur me relacionin?

Klodiana Veizi (Mema)- po, më fal, në seancën e kaluar ishin paraqitur edhe dokumenta shtesë nga ana e kandidatës. Dokumeta të cilat lidheshin me disa njoftime...

Sokol Binaj -ok, çfarë rëndësie ka. Përfituar nga rasti që tu vihej në dispozicion edhe anëtarve në mënyrë që të njiheshin në mënyrë të mëtejshme. Ndërkohë edhe gjatë kësaj jave, aq sa jam njoftuar nga ana e sekretarisë, ka vazhduar të dërgoj dokumentacion zonja Semini, lidhur me figurën, vlerësimin. Gjithësesi është çmuar tu shpërndahet anëtarve, nuk e di sesa do tu shërbej për këtë moment apo për më mbrapa por gjithësesi janë në dispozicion në anëtarve. Çfarë ka ardhur në vazhdimësi u janë transmetuar anëtarve pa vonesë. Atëherë, vazhdojmë me diskutimet! Zonja Toska.

Elsa Toska – atëherë faleminderit Kryetar dhe na falni për vonësën arsye objektive! Ishim në një seancë të hapur që zgjati tej parashikimit. Unë jam gati për vendimarrjen. Nuk kam asnjë pyetje për relatorin. E falenderoj për punën e bërë deritani. Tani jam gati të shkoj në dhomë këshillimi për vendimarrje.

Sokol Binaj-zonja Leka

Anila Leka – jam njohur me raportin e ILDKPKI-së për kandidaten. Jam njohur me relacionin e bërë nga relatorja, me gjithë korrespondencën që ka sjellë kandidatja. Nuk kam pyetje, as kërkesa për veprime shtesë, edhe unë jam në gjëndje për vendimarrje.

Sokol Binaj – faleminderit! Zonja Xhaferllari

Edlira Petri – Meqënëse isha unë që kërkova kohë po e zgjas pak më shumë qëndrimin tim. U njoha me raportin e ILDKPKI-së, por u njoha edhe me dosjen e ILDKPKI-së që ishte në formatin elektronik. Dhe me thënë të drejtën në raportin e ILDKPKI-së, nuk gjejnë pasqyrim veprimet administrative që vetë ILDKPKI-ja ka kryer gjatë kontrollit të pasurisë. I ka bërë rreth 25 pyetje kandidatës, për të cilat kërkuar sqarime. Nuk po zgjatem, i kam lexuar të gjitha, përfshirë këtu edhe një sqarim lidhur me një deklaram të një shumë rreth 2 milion e 500 mijë lekë që gjëndet në deklaratën e pasurisë, që është sqaruar më pas si një gabim dhe një pasaktësi sepse nuk ka qenë, nuk ka egzistuar. Janë kërkuar sqarime në lidhje me shumën e dhurimit që i ka bërë babai, familja e babait në blerjen e një pasurie të paluajtshme, pasuri që është blerë në vitin 2003. Në përgjigje të kësaj pyetje kandidatja ka paraqitur një deklaratë noteriale në emër të vëllait që deklaroi që shuma prej 9 mijë \$, dhuruar nga familja e babait, dhe pastaj ka paraqitur disa deklarata për të ardhurat e vëllait që datojnë mbas vitit 2003 kur është blerë pasuria dhe për të ardhurat e të atit, që shumica janë para vitit 90` kur pasur detyrën e prokurorit, gjithësesi janë marrë këto sqarime. Është pyetur për disa derdhje cash që ka bërë vetë subjekti apo bashkëshorti në llogarit e tyre për burimin e tyre, që janë shuma të konsiderueshme, jane dhënë edhe për këtë sqarime. Është pyetur për administrimin e një pasurie të paluajtshme

për të cilat kandidatja ka caktuar me prokurë njëherë nënën e saj pastaj vëllain, më pas ata e kanë dhënë me qera mbi bazën e kësaj prokure. Rezulton që qeradhënës janë përfaqësuesit dhe jo e përfaqësuar. Ka dhënë edhe sqarime për këtë. Edhe disa çështje të tjera, për të cilat nuk po i hap letrat se...unë jam njohur me aktet, do ishte mirë të kishin gjetur pasqyrim sepse janë çështje që dihen. Vë në diskutim le të themi si burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e pasurive si dhe volumin e të ardhurave që ka realizuar kandidatja.

Sokol Binaj – zoti Dhimitri

Anton Dhimitri – edhe unë jam njohur me aktet sidomos me raportin. Kam të njëjtin konstatim si zonja Petri, raporti i ILDKPKI-së nuk ishte i detajuar në episode të saktuara. Bënë një analizë të përgjithshme të të ardhurave, të shpenzimeve dhe nuk është futur për të analuar në mënyrë të detajuar burimin e krijimit të çdo pasurie në mënyrë të veçantë. Ka një problem për burimin e të ardhurave përpara vitit 2005 por që ky problem pastaj është ezauruar në përgjigje të korrespondencës që KED-i i ka dërguar ILDKPKI-së, dhe këto problematika sqarohen në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave para vitit 2005 dhe në këtë kuptim nuk kam gjë tjetër për të shtuar, jam gati për vendimmarrje.

Sokol Binaj- faleminderit! Zoti Kapo

Etien Kapo – edhe unë jam njohur si me relacionin dhe me aktet dhe së fundmi me dy emaillet e dërguara nëpërmjet postës elektronike dhe jam i gatshëm për vendimmarrje.

Sokol Binaj – zonja Veizi ka bërë raportet

Klodiana Veizi (Mema)– po, patjetër, unë kam qenë gati për vendimmarrje dhe kam gjetur raportin e ILDKPKI-se sikundër e kam thënë herën e kaluar një raport të plotë. Kandidatja është pyetur, ka dhënë shpjegime. Tek e fundit kam bindjen edhe KED, nuk e ka kurrë atë lloj kapaciteti me personel si përsa i përket personelit juridik ashtu edhe përsa i përket personelit me njohuri në fushën e ekonomisë që të hedh poshtë apo të bëj, apo të konkludoj ndryshëm nga sa ka konkluduar ILDKPKI-ja. Kështu që, unë mendoj që raporti është i saktë, është i plotë. Marrëdhënia e KED-it me ILDKPKI-në është një marrëdhënie që mbështetet në parimin e bashkëpunimit që duhet të karakterizoj marrëdhënien me organet e administratës, në këto nivele që jemi dhe ne. Kështu që, nuk shoh asnjë indicie për të vënë në dyshim konkluzionet e sakta dhe të qarta të ILDKPKI-së.

Sokol Binaj – Faleminderit! Ndërkohë verifikohet prezenca e zonjës Xhaferllari, sapo u paraqit, me motive të vonësës të sqaruara pak më përpara. Jemi në kohë për t'i dhënë fjalën asaj për tu prononcuar, nëse është gati lidhur me arsyen e ngritur sot në rendin e ditës, për vazhdimin e zonjës Semini. Jemi në diskutimin është i plotë apo jo materiali, mbasi diskutuam të gjithë. Unë jam i fundit. Opinioni juaj, jemi gati të hyjmë në vendimmarrje?!

Marsida Xhaferllari –në mbledhjen e shkuar, unë isha dakort me shumicën që të vendosej shtyrja. Nuk kam qenë unë që kam kërkuar shtyrjen, kështu që jam dakort që të vazhdojmë. Faleminderit!

Sokol Binaj – faleminderit! Atëhere, opinioni im është se materiali është i plotë. Jemi në kushtet për të proceduar me vendimmarrjen në dhomën e këshillimit. Zoti Haxhimihali?

Enio Haxhimihali–institucioni im, nuk ka komente.

Sokol Binaj – faleminderit.

Këshilli tërhiqet në dhomë këshillimi për vendimmarrje.

Sokol Binaj – atëhere.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pasi u kthye nga dhoma e këshillimit, përfundimisht

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatës Mariana Semini (Tutulani), në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Shqipërisë në datën 16.01.2022.

2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës Mariana Semini (Tutulani).

Gjithashtu, lidhur me mbledhjen e ardhshme nga ana e KED me rendin e ditës së konkludimit të procedurës të kësaj vakance, me fillimin e procedurës të pikëzimit për këtë vakancë, u ra dakord që mbledhja e ardhshme brenda afatit 5 ditësh, do të zhvillohet ditën e hënë, **dt. 21.11.2022, ora 14.30**. Pjesëmarrësit morën dijeni.

Deklaroj të mbyllur mbledhjen për ditën e sotme.

Tiranë në datë 15.11.2022

KRYETAR

Sokol BINAJ

